



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Kuvendi i Komunës së Prishtinës

PJESA I E KONTRATËS: KONTRATË PUBLIKE

Komuna e Prishtinës, Rruga UÇK.nr.2 ne tekstin e mëtejme ("Autoriteti Kontraktues"), në një rën anë dhe

OE-ik N.N.P. "WENDA". adresa: Fshati Dolak-Vushtrri , me numër te regjistrimit te biznesit 80281714 dhe numër fiskal 600203939 , përfaqësuar nga drejtori –Kadri Selmani ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për punët e shënuara me poshtë :

Ndërtimi i krahut të rrugës dhe kanalizimit fekal te lagja Leci-Prugovc me numër Identifikues **616-18-9227-5-3-6**

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Ndërtimi i krahut të rrugës dhe kanalizimit fekal te lagja Leci-Prugovc**
- 1.2 Kontrata hynë në fuqi me *daten e nenshkrimit* dhe përfundon ne afat prej 30 diteve.
- 1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 10ditë nga data e marrjes së urdhëreses.
- 1.4 Vendi i *[ekzekutimit të punëve]* do të jetë ne *Lagjen Leci-Prugovc*
- 1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: [9,333.00] €; [Nëntë mijë e treqind e tridhjetë e tre] Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas përfundimit të punëve]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i [punëve] duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të [punëve].

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [te kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve

tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [punëve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **Gjykatën Themelore-Prishtinë në** në pajtim me ligjin e Kosovës.


b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të **Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.**

Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen [Shqipe] në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik		Për Autoritetin Kontraktues	
Emri:	Durhaci Selman	Emri:	ZEKË PARDHAJ
Pozita:	Menaxher	Pozita:	Udhëheqës i PROKURIMIT
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	31.08.2018	Data:	31.08.2018
Vula:		Vula:	

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 616-18-9227-5-3-6

Titulli i kontratës: Ndërtimi i krahut të rrugës dhe kanalizimit fekal te lagja Leci-Prugovc

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Ndërtimi i krahut të rrugës dhe kanalizimit fekal te lagja Leci-Prugovc

3. Çmimi total i tenderit është:

9.333,00 EUR

Dhe në fjalë *[shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]*

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 30 nga data finale për dorëzim të tenderëve.
5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës
6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender *[shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet]* si partner në konsorcium të udhëhequr nga *[shëno emrin e udhëheqësit]*. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.
7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK
8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj

nesh nëse e bën këtë.

Informacion në lidhje me nënkontraktorët

Emri dhe adresa e nënkontraktorit	Numri fiskal - nënkontraktorë	Përshkrimi i pjesës së kontratës që do të nënkontraktohet	Pjesa vlera të nënkontraktohet	Përqindja e kontratës që do të nënkontraktohet (%)

Paramasa dhe parallogaria

Ndërtimi i krahut të rrugës dhe kanalizimit fokal te lagja Leci- Prugove

Ndërtimi i krahut të rrugës te lagja Leci

Nr.	Përshkrimi i pozicionit PUNËT PARAPRAKE	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1.1	Vendosja e shenjave të përkohshme vertikale dhe shenjave për kontrollë të trafikut gjatë kryerjes së punimeve dhe sigurimi i komunikacionit gjatë punimeve në rrugë. Vendosja e tabeles informuese konform ligjit ne fuqi.	m ¹	80.00	0.70	56.00
1.2	Inçizimi i gjendjes egzistuese, harmonizimi i kotave me hyrjet qasjet ne rrugën egzistuse si dhe perçellja e punimeve gjat egzekutimit.	m ¹	80.00	0.70	56.00
1.3	Mobilizimi dhe rregullimi i punishtes për punë si dhe identifikimi, largimi i te gjitha llojeve instalimeve ne punishte në rast se ka në ato hapësira .	m ¹	80.00	1.00	80.00
2	PUNËT TOKËSORE			Gjithsejt 1:	192.00
2.1	Gërmimi i dheut i kategorisë së II- IV-të me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi max. 15km thellësi h=50cm.	m ³	180.00	1.20	216.00
2.2	Formësimi dhe ngjeshja e nenbazes se trupit te rruges me ngjeshmeri 30Mpa(80x5.0)	m ²	400.00	1.50	600.00
3	KONSTRUKSIONI I TRASËS SË RRUGËS			Gjithsejt 2:	816.00
3.1	Furnizimi , transporti, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit me gurë të thyer te fraksionuar me makina përkatëse deri ne tryesni Mf 60Mpa , shtresa e pare d=25 cm (0-63) mm,	m ³	100.00	5.00	500.00
3.2	Furnizimi , transporti, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit me gurë të thyer te fraksionuar me makina përkatëse deri ne tryesni Mf 70Mpa , shtresa e dytë d=10 cm (0-31) mm,	m ³	50.00	7.00	350.00

3.3	Furnizimi ,transporti dhe montimi i pllakave (kubëzave) nga betoni i klasit 35/37 trashësie d=8cm, të vendosura ne bazen e reres trashësie d=4cm . Tipin, formen dhe dizajnin e cakton organi mbikqyres. Ne çmim te llogaritet edhe rëra e imët e cila i mbulon fugat ndërmjet kubëzave. Shqyrtimet laboratorike per pllakat (kubëzat dhe skajorët) ne shtypje, ngrirje dhe abrazion janë të domosdoshme . Atestet e materialeve të shoqërohen me certifikatat e laboratorit kontrollues para fillimit te punimeve .	m ²	360.00	8.00	2,880.00
3.4	Furnizimi dhe montimi e gurëve skajor nga betoni i klasit C-35/37, në shtresën e betonit me dim. 18x24x100cm.	m ³	170.00	7.00	1,190.00
				Gjithsejt 3:	4,920.00
REKAPITULLIMI					
1	INÇIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKE NË TEREN				192.00
2	PASTRIMI I TERENIT				816.00
4	KONSTRUKSIONI I TRASËS SË RRUGËS				4,920.00
				Gjithsejt: Ndërtimi i krahut të rrugës te lagja Leci	5,928.00
B.	Ndërtimi i kanalizimit fekal (ujërave të zeza)				
Nr.	Përshkrimi i punëve dhe materialeve	Njësia	Sasia	Çmimi më TVSH për njësi-€	Shuma-€
1	Punët përgaditore				

1.1	Mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve në projekt. Në çmim të llogaritet kosto e përpilimit të planit dhe programit punues si dhe e gjithë kosto e transportit dhe vendosjes së makinave dhe stafit punues si dhe akomodimi i përkohshëm i tyre (kjo kontrate perveq qe ka si projekt kanalizimin kryesor te Besise, perfshine edhe sanimin e kanalizimit te nje pjese te Barileves, Lebanes dhe nje pjese ne Kodren e Trimave, në çmim perfishihen edhe dislokimet e punimeve ne kuader te ketyre lokacioneve)	paushall	1.00	40.00	40.00
1.2	Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nëntokësore, zgjedhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi i planit detal operativ që lidhet me procesin e ndërtimit. Në çmim të llogaritet edhe kosto eventuale e detektimit me aparatura elektronike për instalime nëntokësore si dhe evidentimi i saktë i instalimeve që duhet të mirëmbahen gjatë kohës së ndërtimit (rrjeti elektrik, rrjeti telefonik, rrjeti i ujësjellësit, etj)	paushall	1.00	50.00	50.00
1.3	Në çmim të kalkulohet trasimi gjeodezik i vijave ku do të kaloj rrjeti i kanalizimit fekal si dhe përcjellja e punimeve me instrument gjeodezik.	m	1.00.00	0.70	70.00
2	Punët Demoluese			Subtotali 1:	160.00
2.1	Demolimi i gypave të ndryshëm gjatë periudhës së ekzekutimit ngarkimi, transporti (maksimal 5 km përj punishtës) dhe shpikimi i materialit të demtuar në deponinë legjale ose në vendin te cilin e cakton Organi Mbikqyrës	paushall	1.00	45.00	45.00
				Subtotali 2:	45.00

3	Punët tokësore				
3.1	Gërmimi i kanalit për kolektorët kryesor dhe sekondarë në kat. III-IV të dheut, më makinë në gjërësi sipas normave dhe standardeve teknike (varësisht nga diametri i gypit) dhe thellësi sipas profilit gjatësor.	m ³	150.00	1.20	180.00
3.2	Sigurimi i kanalit nga shembja e dheut. Sigurimi bëhet me pahi të parapara sipas normave për këtë lloj pune, sipas detalit në projekt, në të dy anët e kanalit. Sigurimi bëhet për thellësit dhe kategorinë e tokës që janë të parapara më masat e mbrojtjes në punë. Sasitë janë indikative dhe punëkryesi në bashkëpunim më organin mbikqyrës vendos se ku do të aplikohen këto masa. Rrjedhimisht të dy mbajnë përgjegjësinë për këtë proces	m ¹	100.00	1.50	150.00
3.3	Planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi ±1cm. Ky planifikim duhet vertetuar nga organi mbikqyrës para vendosjes së rerës.	m ²	100.00	1.50	150.00
3.4	Ngarkimi dhe transporti i dheut të gërmuar (tepërt) deri në deponi të qytetit ose në vendin ku e cakton organi mbikqyrës në largësi maksimale deri në 5km.	m ³	150.00	0.70	105.00
3.5	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rerës 0-16mm në fundin e kanalit anash dhe mbi gypa.	m ³	50.00	6.00	300.00
3.6	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rerës 0-61.5mm për mbulimin e kanalit dhe ngjeshja në qdo 30 cm, 40 Mpa.	m ³	100.00	1.50	150.00
3.7	Hapja e vrimes horizontale, nën rrugë, depertimi i rrugës me gypë të Çelikut Ø315, L=15.0m, duke përfshur krijimin e hapsirës së nevojshme për realizimin e shpimit	m ¹	15	14	210
4	Punët montuese		Subtotali 3:		1,245.00
4.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN8 për kolektorin kryesor	m ¹	100.00	1.60	160.00
	PESN8 Ø200		Subtotali 4:		160.00

5	Punët e betonit dhe armaturës	m ³	1.00	35.00	35.00
5.1	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit për pllakën e poshtme për puseta me betonarme C-20/25 d=20cm	m ³	1.00	30.00	30.00
5.2	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonimit për kineta më përpunim sipas detalit.	copë	3.00	120.00	360.00
5.3	Furnizimi transporti dhe montimi i tubave (për puseta) prej betonit të armuar Ø1000/1000mm (elemente të parafabrikuara).	copë	3.00	130.00	390.00
5.4	Furnizimi transporti dhe montimi i konuseve për puseta prej betonit Ø1000/700/600mm (elemente të parafabrikuara).	copë	3.00	30.00	90.00
5.5	Punimi dhe montimi i shkallëve prej armaturës Ø20 në çdo 30cm dhe inkastrimi i tyre në beton me lyrje antikorrozive.	cope	2.00	180.00	360.00
5.6	Furnizimi transporti dhe montimi për kyqje te reja: 1. Gyp PESN4 Ø250 mm L=6m 2. Gypa betonit të armuar Ø1000/1000mm (elemente të parafabrikuara një copë, si dhe një konus Ø1000/700/600mm). 3. Kapakë "Beton arme" Ø 70 mm, d = 15 cm dhe me armature rrjete Ø 10 mm. Gjithçashtu në çmimë të përfshihet germimi, zhavori dhe tubuimi.	cope	3.00	120.00	360.00
5.7	Furnizimi, transporti, montimi dhe betonimi i kapakëve nga materiali "KOMPOZIT", sipas standardeve ISO-9001 dhe ISO 14001 më aftesi mbajtëse 40t. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-20/25.	cope	3.00	120.00	360.00
	Subtotali 5:				1,625.00

6	Punët tjera							
6.1	Rregullimi i trases dhe pastrimi i punishtës.	m	100.00	0.50				50.00
6.2	Testimi i rrjetës së kanalizimit sipas udhëzimeve në raportin teknik respektivisht sipas standarteve.	m'	100.00	0.50				50.00
6.3	Matjet gjeodezike dhe përpilimi i dokumentacionit teknik të punëve për punët e zbatuara si dhe dorëzimi të investitori në tri kopje.	m'	100.00	0.70				70.00
				Subtotali 6:				170.00
REKAPITULLIMI								
1	Punët përgaditore							160.00 €
2	Punët demoluese							45.00 €
3	Punët tokësore							1,245.00 €
4	Punët montuese							160.00 €
5	Punët e betonit dhe armaturës							1,625.00 €
6	Punët tjera							170.00 €
								3,405.00 €
Gjithsejt: Ndërtimi I kanalizimit fekal te lagja Leci:								
REKAPITULIM								
A	Ndërtimi i krahut të rrugës te lagja Leci							5,928.00 €
B	Ndërtimi I kanalizimit fekal (ujërave të zeza) tek Lagja Leci L = 100 m							3,405.00 €
								Gjithsejt: 9,333.00 €


 [Illegible handwritten text]